



Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”

**PLANI STRATEGJIK I
UNIVERSITETIT TË MITROVICËS “ISA BOLETINI”
2018-2021**

PËRMBAJTJA

PROCESI I HARTIMIT TË DOKUMENTIT PSUMIB 2018-2021	7
HYRJE.....	8
Profili i UMIB-it.....	8
Autonomia e institucionit	8
Veprimtaria	8
Vështrim i përgjithshëm i gjendjes në UMIB	9
Mbrojtja nga diskriminimi.....	10
Kampusi i ri universitar në Mitrovicë	10
MISIONI DHE VIZIONI I UNIVERSITETIT:	11
MISIONI	12
VIZIONI	13
RIAKTIVIZIMI I INSITUTIT QËNDROR HULUMTUES - SHKENCOR.....	14
PËRMBLEDHJA E STRATEGJIVE KRYESORE DHE INICIATIVAT STRATEGJIKE	15
FUSHAT STRATEGJIKE DHE INICIATIVAT STRATEGJIKE.....	17
Mësimdhënia, kërkimi dhe shërbimi	17
Burimet e mësimit dhe mbështetja e studentëve	17
Akreditimi dhe kontrollimi i cilësisë.....	18
Nivelet/Programet e kërkuara nga tregu.....	18
Zhvillimi i burimeve njerëzore	18
Zhvillimi i sistemit për informim publik	19
Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave	19
Globalizimi / Ndërkombëtarizimi.....	19
MONITORIMI, VLERËSIMI, DHE RAPORTIMI	20
Përfundim	21

SHKURTESAT

KD	Këshilli Drejtues
KP	Komisioni profesional
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
NJA	Njësitë Akademike
PA	Parlamenti Studentor
PSUMIB	Plani Strategjik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”
SA	Stafi akademik
SI	Sistemi informativ
TI	Teknologjia informative
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit
UMIB	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
ZIKP	Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun
ZSC	Zyra për Sigurim të Cilësisë

DOKUMENTET E KONSULTUARA:

Hartimi i dokumentit Plani Strategjik i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, është përpiluar mbështetur në dokumentet dhe në raportet ekzistuese për gjendjen aktuale të fakulteteve të trashëguara si dhe atyre të reja, të organizuara në kuadër të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”. Ky PSUMIB është hartuar në përputhje me dokumentet e cekura më poshtë, andaj objektivat strategjike të UMIB-it korrespondojnë me objektivat e këtyre strategjive nacionale.

Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 të Qeverisë së Kosovës;

Ligji për Arsimin e Lartë i Republikës së Kosovës, 2010;

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021;

Statuti i Përkohshëm i UMIB-it;

FJALA E REKTORIT

Të nderuar,

Në emër të menaxhmentit të UMIB-it, stafit akademik, administratës dhe studentëve, kam nderin dhe kënaqësinë të prezantoj dokumentin Plani Strategjik i Universitetit të Mitrovicës “ Isa Boletini ” për periudhën kohore 2018-2021, i cili do të përbëjë platformën e qëndrueshme të zhvillimit, të kërkimit dhe të inovacionit në UMIB. Ky plan zhvillimor do të shërbej për gjithë UMIB-in si udhërrëfyes në rrugën e zhvillimit të tij për një edukim të mirëfilltë universitar .

Duke vlerësuar miratimin e kësaj strategjie si një hap të rëndësishëm, duhet të jemi të ndërgjegjshëm për punën e madhe që na pret për zbatimin e saj. Ndaj ju ftoj të gjithëve të mbështesim këtë proces dhe të bashkohemi në përpjekjet tona për të realizuar synimet tona të përbashkëta në këtë fushë, e cila njëherit reflekton në zhvillimin e shpejtë e të qëndrueshëm të ekonomisë dhe shoqërisë në përgjithësi.

Veprimet dhe aktivitetet që do të ndërmerren për implementimin e këtij dokumenti do të mundësojnë vazhdimin e zhvillimit të një universiteti të ri dhe rolin e tij, me një qëllim të caktuar që të njihet në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtar për mësimdhënie të avancuar dhe edukim cilësor. Ky PSUMIB do të ndihmojë në vazhdimin e mëtejshëm drejt ngritjes së cilësisë në mësimdhënie, mësimnxënie dhe zhvillimin e programeve mësimore në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Pavarësisht nga vështirësitë dhe sfidat me të cilat mund të ballafaqohemi në të ardhmen, ky dokument do të jetë një udhërrëfyes për zhvillimin e UMIB-it. Në mënyrë që ky PSUMIB të implementohet në të gjitha pika e tij, të gjithë duhet të jemi kontribut dhënës për zbatimin e tij, andaj të gjithë duhet të veprojmë me forcat tona në drejtim të implementimit të saj. Prandaj duke u bazuar në atë që është cekur më lartë ftoj të gjithë mësimdhënësit, administratën dhe studentët, të lexojnë këtë dokument në mënyrë që të jenë të njohur me parashikimet për zhvillimin e Universitetit tonë.

Me këtë rast, dëshiroj të falënderoj përzemërsisht të gjithë ata që kontribuan me punën e tyre me rastin e hartimit të dokumentit të Plani Strategjik i Universitetit të Mitrovicës “ Isa Boletini ” për periudhën kohore 2018- 2021, e veçanërisht përgëzoj Komisionin - Grupin Punues dhe të gjithë stafin, që kanë kontribuar me komentet dhe sugjerimet e tyre shumë të vlefshme në përpilimin e këtij dokumenti me shumë vlerë .

Me respekt,

Prof. Dr. sc. Alush Musaj, Rektor

PROCESI I HARTIMIT TË DOKUMENTIT PSUMIB 2018-2021

Duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 10 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe nenin 22, paragrafin 1.2, të Statutit të Përkohshëm të UMIB-it (për përgjegjësitë e Këshillit Drejtues për të hartuar një plan strategjik për Universitetin e Mitrovicës), Këshilli Drejtues i UMIB-it në mbledhjen e mbajtur me datën 28.09.2017, me vendimin numër 1307/005, vendosi për emërimin e Komisionit Profesional për hartimin e dokumentit PSUMIB për periudhën kohore 2018-2021. Nga data e miratimit të këtij dokumenti të gjitha aktivitetet zhvillimore të UMIB-it do të udhëhiqen nga ky dokument i cili njëkohësisht do të jetë edhe tregues i performancës së strukturave menaxhuese të UMIB-it mbi bazën e monitorimit dhe rishikimit vjetor të tij. KD ka emëruar Komisionit profesional të përbërë prej 5 anëtarësh:

1. Prof. ass. dr Nurten Deva , kryetare,
2. Prof. dr Izet Zeqiri, anëtar
3. Prof. dr. Naser Peci, anëtar
4. Prof. ass. dr . Faton Merovci, anëtar
5. Msc. Burim Gashi-përfaqësues i MASHT-it

Si grup punues së pari kemi kompletuar portofolin e gjithë dokumentacionit relevant për hartimin e dokumentit të PSUMIB me fokus në dokumentet strategjike të MASHT për arsimin e lartë, dokumentet sektoriale strategjike të UMIB-it (për kërkime-hulumtime, për sigurimin e cilësisë), dokumente ndërkombëtare të arsimit të lartë, etj. Përgatitja e dokumentit ka ndjekur dinamikën e aprovuar nga KD që ka përfshirë fazat: draftimin e dokumentit nga grupi punues, finalizimi i dokumentit për diskutim publik me zyrat menaxheriale dhe njësitë akademike, para se të aprovohet nga KD.

Komisioni profesional i ngushtë ka mbajtur disa 6 takime pune dhe konsultative në të cilat ka përcaktuar shtyllat prioritare dhe ka punuar një draft dokument inicial. Ky draft dokument u është dërguar për diskutim publik, zyrave menaxheriale edhe njësite akademike të UMIB-it, duke marrë për bazë të gjitha përgjegjësitë që nxjerr dokumenti për punën e tyre.

Komisioni profesional e ka të njohur faktin se kjo strategji lidhet drejtpërdrejtë me prioritetet e UMIB-it, për zhvillim të qëndrueshëm 2018 – 2021, prandaj Këshilli Drejtues falënderon të gjithë ata që kontribuuan në çfarëdo mënyre në hartimin e dokumentit të PSUMIB për periudhën kohore 2018-2021.

Prof. ass. dr. Nurten Deva

Kryesuese e Komisionit profesional

HYRJE

Profili i UMIB-it

Themelet e studimeve të arsimit të lartë në Mitrovicë u vunë me hapjen e Shkollës së Lartë Teknike në vitin 1961. Në vitin 1970 në kuadër të Fakultetit Teknik hapen degët e Xehetarisë, Teknologjisë dhe Metalurgjisë, fillimisht në Mitrovicë, viti shkollor 1970/71, për të vazhduar pastaj në Prishtinë. Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë është themeluar me Ligjin nga Kuvendi i Kosovës me datën 22 korrik 1974 dhe studimet u organizuan në këto degë: Xehetari, Teknologji dhe Metalurgji, kurse në vitin shkollor 1980/81 hapet edhe dega e Gjeologjisë.

Mbi bazën e këtyre fakulteteve dhe duke u bazuar në traditën mbi 60 vjeçare të arsimit të lartë në Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 06.03.2013 ka themeluar Universitetin Publik të Mitrovicës, kurse Kuvendi i Kosovës me datën 31 maj 2013 ka ratifikuar vendimin. Në bazë të Statutit të Përkohshëm, miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kuadër të UMIB-it funksionojnë gjashtë fakultete: Fakulteti i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike, Fakulteti Juridik, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Edukimit.

Autonomia e institucionit

UMIB-it i është garantuar liria e krijimtarisë arsimore dhe shkencore, e cila përfshin të drejtën e stafit akademik dhe studentëve që të shqyrtojnë në mënyrë kritike njohuritë e fituara, të ofrojnë ide të reja dhe opinione të diskutueshme pa u ekspozuar nga ndonjë hakmarrje dhe të drejtën e lirisë së fjalës e që mund të kufizohet vetëm me ligj. Universiteti është i pavarur në realizimin e aktiviteteve të veta dhe hapësirat e tij janë të pacenueshme në përputhje me ligjin.

Veprimtaria

UMIB-i është një institucion publik, arsimore-shkencor, i cili ofron arsimin e lartë dhe mban përgjegjësinë shtetërore dhe qytetare në edukimin e mirëfilltë të rinjve të Republikës së Kosovës, për t'i përgatitur këta si qytetarë të denjë dhe të dobishëm për vendin. Në kuadër të aktiviteteve të UMIB-it, në mënyrë të pavarur dhe /ose në bashkëpunim me partnerët e tij, studentët mund të ndjekin studimet e ciklit të parë bachelor, studimet e ciklit të dytë master dhe jemi në përpjekje e sipër për hapjen e studimeve të ciklit të tretë doktoratës, poashtu bazuar në Statut mund të ofrohen programe të trajnimit dhe formimit profesional. UMIB-i në mënyrë të pavarur, ose në bashkëpunim me institucione të tjera arsimore hulumtuese, performon hulumtime bazë dhe aplikative, si dhe kërkime që janë në funksion të zhvillimit të aktiviteteve arsimore. Universiteti mund të performojë edhe aktivitete të tjera në funksion të aktiviteteve të saj të regjistruara, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe konform Statutit të tij.

Roli i UMIB-it, qysh prej themelimit e deri në ditët e sotme, ka qenë dhe është një burim i intelektit dhe i ndryshimeve politike, ekonomike dhe shoqërore në përparim të vendit dhe shoqërisë kosovare. Në UMIB, studimet organizohen dhe implementohen sipas planit dhe programeve të mbështetura në Deklaratën e Bolonjës .

Vështrim i përgjithshëm i gjendjes në UMIB

Përkundër proceseve të shumta politike si dhe ato ekonomike nëpër të cilat vendi ka kaluar, pas vitit 1999 gatishmëria dhe përkushtimi i MASHT-it -së për të ofruar shërbime dhe arsim cilësor nuk ka munguar në asnjë kohë.

Në ditët e sotme gjithnjë e më shumë besohet se një sistem efikas i arsimit të lartë është një kusht i domosdoshëm që të arrihet një zhvillim ekonomik dhe social i qëndrueshëm i një vendi. Që nga qershori i vitit 1999 deri më tani, Kosova përballet me një numër problemesh në sistemin arsimor. Politika të ndryshme që rrjedhin nga ato ligjore, pastaj rregullimi dhe harmonizimi i pamjaftueshëm kombëtar në arsim në nivelin shtetëror, çojnë drejt një qëndrimi të ndryshëm drejt arsimit dhe politikës arsimore, poashtu edhe sektori privat po rrit influencën e tij me hapjen e një sërë fakulteteve dhe universiteteve.

Duke ngritur arsimin e lartë, ose më saktë duke aplikuar njohuritë e fituara dhe aftësitë, është një përfitim për shtetin, por edhe më gjerë. Një komunitet i fortë akademik krijon një klimë pozitive, proaktive që tërheq investime të drejtpërdrejta vendore dhe të huaja, duke rezultuar në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Politika e re evropiane e arsimit të lartë është shumë me rëndësi për vendet e Evropës Juglindore.

Deklarata e Bolonjës thotë:" Rëndësia e arsimit dhe bashkëpunimi arsimor për zhvillimin dhe forcimin e shoqërive të qëndrueshme, paqësore dhe demokratike në përgjithësi konsiderohet një arritje e madhe, e veçanërisht në lidhje me situatën në Evropën Juglindore”.

Komuniteti akademik në Kosovë ballafaqohet me një detyrë të vështirë, që cilësia e arsimit të lartë dhe puna kërkimore shkencore duhet të përafrohet sa më shpejt me Arsimin e Lartë të Bashkimit Evropian. Në këtë rrugë komuniteti akademik duhet të mbështetet nga shteti, mediet, subjektet e bizneseve dhe akterët e tjerë kyç për zhvillimin e shoqërisë.

Zbatimi i nismave të reformës në UMIB ka ardhur nga vetmotivimi dhe entuziazmi i stafit akademik që synojnë të zbatojnë një numër masash me qëllim të rritjes së cilësisë së mësimin.

UMIB-i bënë përpjekjet e saj për të zbatuar proceset e reformave evropiane për përmirësimin dhe harmonizimin e strukturës së arsimit të lartë në përputhje me nevojat specifike të vendit, me qëllim të përmirësimit të efektivitetit dhe konsistencës së masave shoqëruese përmes një kornize për të forcuar kapacitetet institucionale, bashkëpunimin dhe zhvillimin. UMIB-i në periudhën e ardhshme duhet të bëjë çdo gjë të nevojshme për të optimizuar proceset përmes kornizave ekzistuese, ose të reja ligjore si dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë faktorët relevant

pjesëmarrës në këto procese , në mënyrë që ky institucion i arsimit të lartë të jetë konkurruese në tregun evropian të arsimit të lartë.

Pas analizave të hollësishme të punës së UMIB-it me iniciativë të KD dhe rektorit është marrë parasysh se duhet punuar në PSUMIB në të cilin do të adresojmë sfidat dhe nevojat me të cilat përballet sot institucioni. Si rezultat është realizuar dokumenti PSUMIB 2018-2021, i cili do të adresojë gjatë tri viteve në vijim, çështjet që lidhen me ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet e UMIB-it. Qëllimi është të argumentojmë dhe dokumentojmë se ku jemi sot dhe ku ne duam të jemi në të ardhmen, duke parashikuar në këtë mënyrë rritje dhe zhvillim optimal në të ardhmen.

Me qëllim që dokumenti i PSUMIB për periudhën kohore 2018-2021, të jetë bazë e mirë për të ardhmen e punës së menaxhmentit si dhe të gjithë punonjësve, për studentët e tanishëm dhe të ardhshëm, janë zhvilluar një gamë e gjerë e aktiviteteve, në mënyrë që të kemi një dokument sa më real dhe më konciz.

Mbrojtja nga diskriminimi

Universiteti nuk do të lejojë të diskriminohet në aspektin e të drejtave të njeriut asnjë person mbi bazën racore, fetare, origjinës kombëtare ose etnike, moshës (pas moshës madhore), gjinisë, orientimit seksual, gjendjes martesore apo prindërore, aftësisë së kufizuar ose ndonjë paaftësie fizike, statusit civil dhe shtetësisë, burimit të ardhurave dhe statusit material, në veçanti në të drejtën për t'u regjistruar në Universitet, të drejtën për të studiuar dhe të drejtën për arsimim, kushtet për studimin dhe vlerësimin e arritjeve në mësimnxënie, trajtimin dhe angazhimin në Universitet, gjegjësisht mundësi punësimi në Universitet. Mbrojtja nga diskriminimi nga paragrafi paraprak vlen dhe zbatohet edhe për stafin akademik dhe stafin tjetër të punësuar në Universitet.

Kampusi i ri universitar në Mitrovicë

Kampusi i ri universitar në Mitrovicë pritet të jetë gati për studentët në mars të vitit 2018, respektivisht në 5-vjetorin e themelimit të UMIB-it. Kampusi i ri është i shtrirë në një hapësirë prej 17 hektarësh, ku tashmë vetëm sa ka përfunduar një objekt universitar, ndërsa një tjetër dhe rektorati janë në përfundim. Në kuadër të këtij projekti kemi amfiteatro moderne, laboratorë, salla dhe gjithçka që kërkohet prej një objekti modern universitar. Në ndërtim e sipër është edhe rregullimi i një parku brenda hapësirës universitare, ndërsa më vonë planifikohet edhe ndërtimi i konvikteve dhe mensës. Këto hapësira do të krijojnë kushte jashtëzakonisht të mira për studentët, stafin akademik dhe stafin administrativ. Mungesa e hapësirës ka qenë sfida kryesore për Universitetin “Isa Boletini”, meqë është punuar në disa objekte të improvizuara të ndërmarrjes “Trepça”.

MISIONI DHE VIZIONI I UNIVERSITETIT

UMIB-i është qendër për arsimin e lartë në nivel regional të komunës së Mitrovicës, kështu që edhe puna kërkimore e studentëve dhe stafit akademik (SA) është të punojnë në përputhje me vlerat akademike në arritjen e përsosmërisë dhe kreativitetit më të madh në mësim dhe hulumtim, kështu që me një bashkëpunim të hapur dhe produktiv mund të arrihet zhvillimi i shoqërisë, ekonomisë dhe kulturës, bazuar në parimet bazë të njohurisë, kreativitetit, inovacionit, si dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Universiteti misionin dhe vizionin për të ardhmen e bazon në qëllimet e vendit që synon proceset e ndryshimit, reformave dhe tranzicionit në një shoqëri demokratike, sundimi i ligjit, shtetit i së drejtës ligjore dhe ekonomisë së tregut të lirë. Nuk ka dyshim se në këtë epokë të re, duhen njohuri të reja, të cila kryesisht do të dëshmojnë një hap përpara nga mjedisi aktual kulturor drejt një pamjeje të re të botës dhe një qasje të ndryshme për ekonominë, sistemin ligjor, kujdesin shëndetësor, shpërndarjen e informacionit dhe përvetësimin e njohurive.

Universiteti me thënien "Shkolla e Njohurive Evropiane" fillon nga përvoja e vendeve më të suksesshme dhe të zhvilluara në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë. Kjo do të thotë që procesi i mësimin dhe standardet arsimore duhet të krijojnë personel të arsimuar në fusha multi disiplinuar me njohuri të fokusuara (përqendrohen) në zhvillimin e aftësive kreative të studentëve.

Misioni shoqëror i universitetit është i fokusuar në edukimin dhe arsimimin e personelit të ardhshëm dhe udhëheqësve (liderëve) të aftë për të krijuar një strategji të qëndrueshme sociale, ekonomike dhe teknologjike të shtetit, duke i vlerësuar burimet njerëzore që do të kualifikojnë brezin e ri akademik për t'u përballur me mjedisin e tyre civil, ekonomik dhe sfidat e së ardhmes.

Për qëllime të edukimit dhe zhvillimit shkencor - kërkimor, angazhohet personeli me dinjitet të lartë shkencor, koeficienti i kompetencës i të cilit është në përputhje me njohuritë, aftësinë dhe gatishmërinë e tyre për të marrë përgjegjësi për rindërtimin e komunitetit të tyre lokal dhe global, transformimin e këtyre komuniteteve në "shoqëri të dijes" dhe "shoqëria e të mësuarit".

Universiteti do të zbatojë gjithashtu parimet e mësimin gjatë gjithë jetës (*life-long learning*) në realizimin e të drejtave themelore të njeriut në mësim dhe arsim, mobilitetin e studentëve dhe profesorëve, "dimensionin evropian" (vlerat e Evropës së bashkuar) në arsimin e lartë, sigurimin e cilësisë, kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë, edukimin ku studenti do të jetë në qendër, publicitetin, transparencën dhe akumulimin e të gjitha formave të punës në sistemin e vlerësimin dhe arritjeve të studentëve, studimet e hartuara për matjet intelektuale dhe psikologjike të tyre dhe një zhvillim të gjithanshëm të kërkimeve dhe funksioneve të biznesit të Universitetit si një qendër inkubacioni dhe karriere.

Misioni dhe Vizioni i Universitetit bazohen në këto parime akademike:

- Universiteti është një e mirë publike;
- Universiteti është i pavarur në fushën e arsimit dhe kërkimit, me përgjegjësinë e plotë për veprimet e tij;
- mësimdhënësit kanë liri akademike në hartimin dhe realizimin e orëve në përputhje me njohuritë përkatëse shkencore dhe metodike, në përputhje me programin e pranuar të studimit si dhe standardet e cilësisë në Universitet;
- Përsosmëria arrihet duke përhapur arsimin, kërkimin dhe krijimin;
- Të gjithë studentët, stafi akademik dhe kërkuesit kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në arsimim dhe kërkime, në përputhje me kompetencat e tyre personale dhe interesat e tyre ;
- puna akademike bazohet në ndershmëri, besim, drejtësi dhe respekt të ndërsjellë.

MISIONI

UMIB-i është institucion publik i arsimit të lartë me karakter mësimor, shkencor dhe inovativ. Si i tillë qëllimi primar i misionit të vet është fokusi që të ofrojë programe studimore moderne dhe dinamike, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimitarive akademike, të përshtatura plotësisht me standardet botërore dhe kërkesat e shoqërisë, ku qytetarëve të Kosovës dhe atyre jashtë saj do t'u ofrojë edukim cilësor, hulumtues dhe inovativ, nga do të përgatisë studentë konkurrues në tregun e punës, lider të së ardhmes në fushat përkatëse si në Shkencat teknike, siç janë: Gjeoshkenca, Makineri, Informatikë, Teknologji Ushqimore, përfshirë edhe Shkencat sociale, si: Ekonomik, Juridik dhe Edukim. UMIB-i, nëpërmes aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare do t'i përkushtohet edhe kultivimit të tolerancës, rritjes së cilësisë, sigurimit të një mjedisi më të favorshëm kërkimor për stafin dhe studentët për të fituar njohuri, shkathtësi dhe kompetenca, të cilat do ta rrisin konkurrencën e tyre në nivel regjional, kombëtar dhe atë evropian, si në tregun global të punës, po ashtu edhe brenda komunitetit akademik. E gjithë kjo do të arrihet nëpërmes mësimdhënies dhe punës kërkimore e shkencore, me një staf akademik të specializuar në drejtimet përkatëse dhe me teknologjinë më të avancuar për demonstrimin e punës praktike. Universiteti si institucion edukues dhe kërkimor-shkencor, përfaqëson bindjen se zhvillimi gjithëmbarshtëm i shoqërisë në tërësi do të vijë vetëm si rezultat i ngritjes së kapaciteteve njerëzore në të gjitha fushat e jetës. Misioni i tij është:

- Të veprojnë si qendër udhëheqëse për avancimin e diturisë, ideve dhe shkencës në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës;
- Të luajnë rolin udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;
- Të ndihmojnë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
- Të synojë të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësim nxënies, kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike;
- Të shfrytëzojnë burimet e veta në mënyrë sa më efikase;

- Të bashkëpunojë maksimalisht dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e arsimit të lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- Përshtatja me standardet evropiane;
- pg. 13 Të integrohet plotësisht në zonën evropiane të arsimit të lartë (konform Deklaratës së Bolonjës, Konventës së Lisbonës mbi Njohjen dhe në zonën evropiane të kërkimeve Shkencore) si dhe të ndërmarrë hapat adekuat reformues të nevojshëm për arritjen e këtij objekti;
- Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë, e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, veprimtarisë kërkimore-shkencore e inovacionit, si dhe shërbimeve në fushat e shkencave ekzakte dhe shoqërore.

VIZIONI

Universiteti i Mitrovicës synon të jetë një ndër institucionet publike prijëse të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Kosovës, i fokusuar në zhvillimin e cilësisë, mësimdhënie cilësore dhe hulumtim, pjesëmarrjes aktive e debateve në shoqëri dhe mbështetës i zhvillimit të gjithëmbarsuem ekonomik dhe shoqëror në Republikën e Kosovës.

Deri në vitin 2021, UMIB-i synon të bëhet një institucion i hapur, tërheqës për studentët jo vetëm të Kosovës dhe regjionit, pra institucion i lartë arsimor me renome dhe rëndësi rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllime të qarta për zhvillimin e profesioneve të ardhshme dhe përfshirjen e vazhdueshme të stafit akademik në zgjidhjen e çështjeve aktuale të jetës shoqërore në rajon dhe më gjerë.

Ne e përcaktojmë vizionin dhe efektin e dëshiruar si një ide e gjerë e UMIB-it, në përputhje me kornizën ligjore ekzistuese. Një koncept me ndikim të gjerë i UMIB-it për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2021, është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për zhvillim të qëndrueshëm, veçanërisht në aspekte të realizimit të qëllimeve të përcaktuara.

UMIB-i, në sajë të rezultateve të punës shkencore dhe arsimore, shquhet si një institucioni me rëndësi në fushën e shkencave teknike nëpërmjet arsimimit të inxhinierëve në të gjitha nivelet e profileve të ndryshme në shkencat teknik, poashtu edhe shkencat shoqërore, janë të pranishme në të gjitha sferat e jetës së përditshme dhe zënë një vend të rëndësishëm për kontribut dhënie në ndërtimin e një të ardhme më të ndritshme dhe me prosperitet të qytetarëve të Kosovës.

RIAKTIVIZIMI I INSITUTIT QËNDROR HULUMTUES - SHKENCOR

Sot ekonomia e lëndëve të para dhe ekonomia e materialeve janë dy komplekse shkencore që luajnë një rol qendror në zhvillimin e çdo vendi. Ekonomia e lëndëve të para përfshinë hulumtimin, gjetjen dhe shfrytëzimin e lëndëve të para, derisa ekonomia e materialeve të gjitha kriteret vlerësuese si dhe parametrat fiziko - kimik, teknik e ekonomik të materialeve, si produkte finale të lëndëve minerale.

Qasja dhe investimet në hulumtimin shkencor janë bazë e përmirësimit të kualitetit mësimor dhe aftësisë të mësimdhënësve dhe studentëve sipas standardeve ndërkombëtare. Për projekte inovative me potencial të lartë për të ardhmen, ndërtim akademik dhe modernizim të studimeve duhet infrastrukturë moderne shkencore.

Duhet t'i kushtohet vëmendje e posaçme që të riaktivizohet Instituti kërkimor – shkencor në nivel të UMIB-it, dhe në kuadër të cilit do të operonin qendrat Kërkimore-Shkencore dhe të cilat do të duhej të ushtronin një sërë kompetencash funksionale ndër të cilat:

- Hartojnë programin dhe planin e punës për çdo vit akademik ku pasqyrohen drejtimet kryesore të veprimtarisë, të miratuar nga Senati akademik;
- Bashkërendojnë punën me njësitë e tjera të universitetit;
- Organizojnë konsulta për tema dhe probleme të rëndësishme që lidhen me politikat dhe vizionet e NJA në tërësi;
- Studiojnë dhe paraqesin për miratim në Senatin akademik projekte kërkimore dhe mësimore duke mbajtur parasysh standardet bashkëkohore;
- Nxitin individualisht pedagogët dhe drejtuesit e njësive bazë për punë në projekte kërkimore-shkencore;
- Bashkërendojnë dhe koordinojnë veprimtaritë kërkimore të departamenteve, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik;
- Promovojnë veprimtarinë kërkimore-shkencore të universitetit, brenda dhe jashtë vendit;
- Inkurajojnë krijimin e një gjenerate të re kërkuesish shkencor në fushat e politikave sociale, ekonomike dhe shkencore;
- Marrin pjesë në programe që financojnë projekte kërkimi nga donator të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit;
- Sjellin më afër komunitetin e biznesit me botën akademike, ofrojnë konsulentë dhe shërbime të drejtpërdrejta për komunitetin e biznesit, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e teknologjisë së informacionit, kërkimin, zhvillimin, inovacionin si dhe ekonominë e bazuar në dije e shkencë;
- Ndjekin zbatimin e orientimeve, planeve, projekteve, tematikave dhe problematikave të miratuara nga njësitë bazë.

PËRMBLEDHJA E STRATEGJIVE KRYESORE DHE INICIATIVAT STRATEGJIKE

Universiteti në përputhje me misionin dhe vizionin e përcaktuar, si dhe qëllimet e punës është i orientuar dhe i vendosur që në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike të zhvillojë strategjinë e vet, të monitorojë dhe përmirësojë sistemin e menaxhimit të cilësisë, për periudhën kohore 2018-2021. UMIB-i, sipas të gjithë treguesve përkatës, është universitet i njohur me qëllimet e tij për zhvillimin e kërkimeve të tij shkencore në fushën e lëmvive inxhinierike dhe në fushat e lëmvive ekonomike, juridike dhe atyre edukative. Bazuar në këto fakte mund të konkludojmë se si i tillë njëherit paraqet potencial të madh për zhvillimin ekonomik të vendit. Ne vlerësojmë se UMIB-i ka nevojë për të investuar në zonat e shërbimit bazë, për të mbetur konkurrues në afat të shkurtër dhe kemi identifikuar një sërë përparësish për këto investime të menjëhershme. Marrja me këto prioritete është domosdoshmëri, në qoftë se Universiteti do ta ruajë udhëheqjen e duhur për t'u bërë një prani globale. Kështu që UMIB-i dhe njësitë e saj organizative duhet të bëjnë përpjekje të mëtutjeshme shtesë për të kontribuar për të krijuar një ambient hulumtimi më të mirë dhe më stimulues për gjeneratat e reja.

Për nga natyra që karakterizon UMIB-in, ai është "përgjegjës" për trekëndëshin e diturisë: edukim - hulumtimi –inovacione (risi). Duhet poashtu të merret parasysh se promovimi i inovacionit është ndër qëllimet kryesore strategjike të BE-së , sepse risitë konsiderohen se janë nxitësi kryesor i zhvillimit të një universiteti.

Në kuptimin e zhvillimit, duhet të bëhen disa aktivitete për të përmirësuar punën e UMIB-it me qëllim të rritjes së kompetencës dhe përsosmërisë. Për këtë qëllim, janë formuluar prioritete bazë dhe qëllimet strategjike. Strategjia e institucionit planifikohet të orientohet duke përfillur pikat si në vijim që janë të dhëna:

Objektivat dhe qëllimet e përgjithshme të zhvillimit të UMIB-it

- ✓ Edukimi i studentëve në universitet të bazohet në përvojat dhe traditat më të mira në rajon , universiteteve evropiane, botërore dhe zbatimit të të gjitha parimeve të reformës të iniciuara nga Procesi i Bolonjës i Reformës Evropiane të Arsimit të Lartë;
- ✓ Ngritja dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara arsimore për të rritur reputacionin e Universitetit tek studentët tanë dhe në publik;
- ✓ Sigurimi i shërbimeve arsimore dhe shkencore të mësimdhënies në përputhje me kërkesat , pritjet dhe me mundësitë e studentëve tanë dhe shoqërisë në tërësi;
- ✓ Të sigurojë përputhjen e punës së Universitetit me rregullat ligjore, aktivitetet dhe të sigurisë së punës të Universitetit;
- ✓ Sigurimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndosh për të gjithë të punësuarit;
- ✓ Përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve, sistemeve dhe aftësive të punës ;
- ✓ Nxitja e Ekselencës Kërkimore;
- ✓ Të mësuarit për një botë me diversitet;

- ✓ Globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve akademike.

Qëllimet e zhvillimit janë krijuar në të gjitha funksionet relevante dhe nivelet brenda Universitetit. Universiteti me qëllim të përmbushjes së misionit të tij vazhdimisht monitoron, analizon dhe përmirëson proceset e tij përmes:

- ✓ Analiza e reagimeve nga palët e tjera ;
- ✓ Monitorimin e realizimit të procesit mësimor;
- ✓ Analiza e suksesit të studimit;
- ✓ Monitorimin e zbatimit të procesit të shërbimit;
- ✓ Aplikimi i metodave dhe teknikave për përmirësimin e cilësisë;
- ✓ Monitorimin dhe analizimin e planit të biznesit;
- ✓ Implementimi i auditimeve të brendshme;
- ✓ Ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese dhe preventivat -parandaluese.

Kjo është arsyeja pse angazhimi i Universitetit është për të zhvilluar programe multi disiplinuar studimore nga fusha shkencore të marginalizuara, të cilat kanë potencialin më të madh për të ardhmen dhe për zbatimin e teknologjive moderne pedagogjike bazuar në mësimdhënie interaktive, si dhe punëtori moderne pedagogjike.

Në planin më poshtë identifikuar janë fushat strategjike të fokusit dhe iniciativat strategjike të veprimit. Çdo fushë strategjike është ndarë në iniciativa strategjike me objektiva, detyra-aktivitete, afatet kohore, stafin përgjegjës dhe burimet e nevojshme për të realizuar iniciativën. Iniciativat strategjike të listuara janë hartuar me qëllim që secila të jetë e veçantë (të mos përsëriten), por në një plan organizativ kompleks disa nga iniciativat mund edhe të duken si të përsëritura apo të ngjashme.

FUSHAT STRATEGJIKE DHE INICIATIVAT STRATEGJIKE

Mësimdhënia, kërkimi dhe shërbimi

UMIB është i përkushtuar për cilësi në mësimdhënie duke u fokusuar në pikat si më poshtë :

- Trajnimi i stafit në metodat e mësimdhënies në përshtatje të lëndës dhe nevojave të studentëve;
- Përmirësimi i mësimdhënies duke përdorur metodologji të reja;
- Sigurimi i zhvillimit të stafit akademik në pedagogji;
- Nxitur kërkimin shkencor tek mësimdhënësit dhe studentët, duke ofruar praktikë mësimore krahas teorisë;
- Krijimi i praktikës për Shërbim të Komunitetit nga stafi akademik.

Burimet e mësimin dhe mbështetja e studentëve

Universiteti do të sigurojë burime të mjaftueshme adekuate dhe bashkëkohore për mësim, të cilat do të jenë në dispozicion të studentëve në të gjitha programet e studimit.

- Ofrimi i shërbimeve në lehtësim të procesit të mësim nxënies dhe realizimit të detyrave Studentore;
- Sigurimi i komunikimit të vazhdueshëm student-mësimdhënës për arritjen e rezultateve më të mira të mësim nxënies;
- Nxitja e studentëve të jenë pjesë aktive e të nxënies dhe të jenë faktor në ndryshimet e nevojshme të proceseve brenda UMIB-it;
- Organizimi i punëtorive tematike të studentëve me qëllim të lidhjes së aktiviteteve mësimore, profesionale dhe shkencore të Universitetit;
- Lidhja në mes aktiviteteve edukative, shkencore dhe kërkimore, si dhe aktivitetet publike
- sigurimi i kushteve për studentët me nevoja të veçanta për qasje sa më të lehtë në kampus dhe në marrjen e shërbimeve nga UMIB-i;
- Zhvillimi i shoqatës Alumni të ish studentëve të universitetit, me qëllim të promovimit të reputacionit të Universitetit në vendin tonë dhe në botë.

Akreditimi dhe kontrollimi i cilësisë

Do të sigurohet cilësia e programeve për sigurim të akreditimit të vazhdueshëm të tyre duke:

- Ndërtuar një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë;
- Analizuar dhe mbikëqyrur vazhdimisht mbarëvajtjen e programeve;
- Ofron programe të reja varësisht prej nevojave të tregut të punës dhe përgatitjes sa më të mire të studentëve për tregun e punës;
- Mbikëqyrur dhe vlerësuar angazhimin e stafit akademik;
- Përmirësimi i mësimdhënies dhe mësim nxënies për të arritur rezultate më të mira të mësimi;
- Rritja e cilësisë së stafit akademik, progresit të studentëve, vlerësimin e lëndës dhe rezultatet e përgjithshme;
- Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të matjes së rezultateve të studentëve;
- Rritja dhe përmirësimi i rezultateve kërkimore në UMIB;
- Përforcimi i marrëdhënieve të Universitetit me botën e punës dhe të shoqërisë civile;
- Fillimi i punës për zhvillimin e programeve të doktoratës në UMIB në përputhje me sistemin e Bolonjës;
- Institucionalizimi i përfshirjes së studentëve në sigurimin e cilësisë.

Nivelet/Programet e kërkuara nga tregu

Lidhje më intensive me subjektet ekonomike në region të cilët janë të interesuar drejtpërdrejt në edukimin e profesionistëve sa më të mire, të cilët përveç kualifikimeve cilësore të njohurive të arritura në nivele të caktuara të arsimit, gjithashtu sigurojnë bashkëpunim cilësor të biznesit në fushën e mësimdhënies.

- Zhvillimin e një sistemi të arsimit të përjetshëm në përputhje me nevojat e tregut;
- Zhvillimi i rezultateve të matshme të programit;
- Rritja e bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat për t'i lidhur programet me kërkesën, aftësitë aktuale dhe kërkesat e njohurive dhe nevojat e ardhshme.

Zhvillimi i burimeve njerëzore

- Zhvillimi i organogramit të organizimit të personelit dhe strukturave të ardhshme të stafit;
- Rritja e trajnimit të stafit administrativ;
- Përmirësimi i rekrutimit dhe praktikave të punësimit;

Zhvillimi i sistemit për informim publik

Universiteti ka për detyrë që rregullisht, tërësisht dhe objektivisht ta informojë publikun për arritjet në Universitet përmes koeficienteve sasiorë dhe cilësorë. Informacioni publik mbi punën dhe rezultatet e punës së Universitetit të jetë në dispozicion për të gjitha palët e interesuara. Universiteti i kushton vëmendje të veçantë komunikimit me palët e interesuara duke ndërmarrë veprime të tilla si:

- Promovimi i Universitetit në publik;
- Rritja e imazhit të institucionit publike nëpërmjet zhvillimit të "marketingut të ngjarjeve" dhe "marketingut të veprimeve";
- Implementimi i sistemit informativ globalisht konkurrues;
- Informimi i të gjitha subjekteve të Universitetit;
- Trajnimi i punonjësve për rëndësinë e komunikimit efektiv.

Llogaridhënia fiskale dhe përmirësimi i informacionit financiar të të dhënave

Sigurimi i menaxhimit racional dhe shpenzimi optimal i fondeve në përputhje me planet, të përqipemi të rrisin pjesën e burimeve vetanake të financimit nga ana e NJA, si mjete shtesë financiare për buxhetin e UMIB-it.

Globalizimi / Ndërkombëtarizimi

UMIB-i gjithnjë inkurajon bashkëpunim më intensiv ndërkombëtar në fushën e mësimdhënies dhe punës kërkimore si parakusht për përfshirjen e Universitetit në projektet shkencore dhe kërkimore evropiane dhe arsimore.

- Rritja e partneriteteve globale;
- Rritjen e mobilitetit të stafit dhe studenteve (Internship, vazhdim studimesh etj.);
- Rritja e numrit të aplikimeve për bursa (Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar);
- Rritja e aplikacioneve të projekteve të përbashkëta për programe të doktoratave dhe marrjen e fondeve ndërkombëtare;
- Baza e të dhënave elektronike për menaxhimin e donacioneve dhe projekteve Ndërkombëtare;
